

## K O N T R A T E

PER KRIJIMIN E SHOQERISE "T.T.A.ALBA-L.A.M." SH.P.K.

Sot me dt. \_\_\_\_\_ 1994, ortaket themelues:

**ALBERTO COLO**

**ANTONINO LA TESSA**

Bashkia e TIRANES e perfaqesuar nga PETRIT SALATI me vullnetin e tyre te lire rane dakort te krijojne Shoqerine "T.T.A.ALBA-L.A.M." sh.p.k. me kushtet e meposhtme:



**N E N I 1.** Shoqeria "T.T.A.ALBA-L.A.M." SH.P.K. ka objekt te veprimtarise se saj:

**PRODHIMIN, TREGETIMIN, IMPORT EKSPORTIN E ARTIKUJVE TE HEKURIT, DURALUMINIT, DRURIT, PLASTIKE SI:PROFILE, DYER, DRITARE, KONSTRUKSIONE TE NDRYSHME SI DHE TREGETIMI I ARTIKUJVE LENDE TE PARE PER KETE QELLIM.**

**N E N I 2.** Qendra e shoqerise eshte ne Rrugen "Jordan Misja" prane U.M.B. Tirane.

**N E N I 3.** Jetegjatesia e shoqerise eshte 25(njzet e pese) vjet dhe mund te rinovohet.

**N E N I 4.** Kapitali themeltar i shoqerise eshte 23.540.000 leke, (220.000 USD) i ndare sipas ortakeve si vijon:



1. ALBERTO COLO                    10.399.834,7 LEKE    (97.194,7 USD)  
ose 44.18% e kapitalit
2. ANTONINO LA TESSA 10.399.834,7 LEKE    (97.194,7 USD)  
ose 44.18% e kapitalit
3. BASHKIA ; TIRANE            2.740.330,6 LEKE    (25.610,6 USD)  
ose 11.64% e kapitalit

**N E N I 5.** Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise. Vendimet e saj merren sipas menyres se pershkruar ne Statutin e shoqerise.

**N E N I 6.** Administrator i shoqerise per palen italiane eshte Z. Antonino La Tessa, i biri i Baldassarre, i datelindjes 17.10.1953, banues ne Mazzano Romano (ROMA) dhe per palen shqiptare PETRIT SALATI. i biri i \_\_\_\_\_, dt \_\_\_\_\_ banues \_\_\_\_\_

**N E N I 7.** Fitimet e shoqerise ndahen mes ortakeve ne perputhje me raportet e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.



**N E N I 8.** Kjo kontrate bashke me Statutin e shoqerise perbejne aktet themeluese te shoqerise.

Per cfare nuk eshte parashikuar, shprehur ne keto akte ortaket do t'i referohen ligjes shqiptare ne fuqi ne kete lende.

**O R T A K E T**

**ANTONINO LA TESSA**

**ALBERTO COLO**

BASHKIA TIRANE  
perfaq. nga PETRIT SALATI  
2

## STATUT

I SHOQERISE "T. T. A. ALBA-L. A. M. "

### KREU I


MBERTIMI. OBJEKTI I VEPRIMTARISE. QENDRA. JETEGJATESIA.

#### NE NI 1

Ne base te ligjit Nr.7512, dt.10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit" dhe ligjes Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaket Alberto Colò, Antonino La Tessa dhe Bashkise, TIRANE perfaqesuar nga Petrit Salati me vullnetin e tyre te lire krijojne shoqerine "T. T. A. ALBA-L. A. M. ", SH. P. K.

Shoqeria eshte person juridik shqiptar, e fiton kete personalitet pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe aktet e saj themeluese (Kontrate dhe Statut).

Ajo pergjigjet para te treteve vetem me kapitalin e saj themeltar per detyrimet e saj dhe jo per detyrimet e ortakeve, ne veprimtarine e tyre te pavarur nga shoqeria, ashtu sikurse edhe keta pergjigjen per detyrimet e shoqerise vetem me kuotat e tyre





respektive ne kapitalin themeltar.

#### N E N I 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

PRODHIMI DHE TREGETIMI I ARTIKUJVE TE HEKURIT, DURALUMINIT, XHAM  
E KRISTAL, DRURIT, SI PROFILE, DYER, DRITARE, KONSTRUKSIONE TE  
NDRYSHME SI DHE TREGETMI I ARTIKUJVE LENDE TE PARE PER KETE  
QELLIM.

#### N E N I 3

Qendra e shoqerise eshte ne Rr. "JORDAN MISJA", prane U.M.B.  
Tirane.

Me vendim te saj shoqeria mund te krijojte qendra dytesore,  
si, filiale, agjensi apo perfaqesi ne Shqiperi dhe jashte saj.

#### N E N I 4

Jetegjatesia e shoqerise eshte 25(njzet e pese) vjet, afat  
ky i rinovueshem nga shoqeria. Gjithsesi ne kufijte e  
jetegjatesise se shoqerise do te merret ne konsiderate norma e  
amortizimit te pasurive te saj, sipas legjislacionit shqiptar ne  
fuqi.

Me vendim te saj shoqeria mund te shperndahet perpara ketij  
afati.

Po keshtu shperndarjen e shoqerise mund ta urdheroje ligji,  
kur verifikohen rrethana te caktuara.

#### N E N I 5

Te gjitha ortaket marrin pjese ne aktin themelues te

shoqerise personalisht.

Administratoret e emeruar jane pergjegjes perpara shoqerise per pavlefshmeri te mundshme te themelimit te shoqerise.

Per kete ata pergjigjen jo vetem perpara ortakeve te tjere por edhe perpara te treteve.

## K R E U II

### KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT


#### N E N I 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 23.540.000 leke, i ndare sipas ortakeve ne menyren e paraqitur ne kontraten e shoqerise. = 220.000 USD

Pershkrimi dhe vleresimi i cdo kontributi ne natyre i kapitalit themeltar i bashkelidhet ketij statuti nepermjet nje raporti te hartuar nen pergjegjesine e tij nga nje ekspert per kontributet, i e *me "anua"* - me unanimitet nga ortaket ose me vendim te gjykates, me kerkese te secilit ortak.

Pjeset respektive te kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer teresiht nga ortaket. Ato nuk mund te perfagesohen nga sherbime apo letra me vlere te tregetueshme.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne kuota, vlere e te cilave nuk mund te jete me e vogel se 1.000 leke.



3 *Juni 80*



## N E N I 7

Ndryshimet ne kapitalin themeltar te shoqerise behen me vendim te Asamblese se Ortakeve dhe kerkone shumicen e vendosur per ndryshimet ne statutin e shoqerise.

Bashkimi i pjeseve te kapitalit themeltar nuk passjell shperberjen e shoqerise.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje ortakun te shtoje angazhimin e tij ne kapitalin e shoqerise.

## N E N I 8


Kuotat jane nominative dhe lirisht te transferueshme mes ortakeve.

Cdo transferim i kuotave behet vetem me akt noterial.


Eshte i lire transferimi i kuotave ne rrugge trashegimie, dhe te pjestimit te pasurise mes bashkeshorteve.

Ortaku shqiptar ka te drejten e transferimit te kuotave te tij sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ortaku qe synon te transferoje kuotat e tij duhet te njoftoje per kete vendim te tij secilin ortak dhe shoqerine shkreserisht. Shoqeria brenda tre muajshnga data e marrjes dijeni duhet te omunikoje vendimin e saj dhe me pas ne rast vendimi negativ nga ana e saj per tre muaj te tjere ortaket vec e vec jane te lire te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes. ne rast te kundert kuotat jane te lira t'ju transferohen te troteve.



4



Ne rast se lind nevoja per vleresimin e kuotave te ortaket do te caktojne nje ekspert dhe kur nje gje e tille nuk arrihet mes tyre, me kerkesen e secilit prej tyre, caktimi i ekspertit behet nga Gjykata e Rrethit, Tirane.

#### N E N I 9

Shoqeria mund te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person, te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit, me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i ribleje ato e te deklaroje zvogelimin e mundshem te kapitalit te saj themeltar.

### K R E U III

#### ORGANET E SHOQERISE. ASAMBLEJA E ORTAKEVE



#### N E N I 10

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise. Vendimet e saj ne perputhje me ligjin e statutin e shoqerise jane te detyrueshme per ortaket.

Cdo ortak merr pjese ne mbledhjen e Asamblese dhe per cdo kuote ne zoterim ka te drejten e nje vote.

#### N E N I 11

Asambleja e Ortakeve thirret nga Administratori apo eksperti



kontabel. Thirrjet behen me shkrim dhe ju komunikohen ortakeve ne vendbanimet e tyre te pakten 20 dite perpara mbledhjes. Ne thirrje shenohet vendi, koha dhe rendi i dites i mbledhjes.

Mbledhjen e Asamblese mund ta kerkojne ortaket qe zoterojne te pakten 10% te kapitalit themeltar, jo me shume se tre here gjate nje viti financiar.

#### N E N I 12

Cdo ortak mund te perfagesohet ne mbledhjen e Asamblese nga nje ortak tjeter apo person i trete, mjat qe keta te mos jene administratore te shoqerise.


Mandatet e perfagesuesve verifikohen nga drejtuesi i mbledhjes.

Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje perfagesues te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar, duke votuar ai vete ne emer te nje pjese tjeter.

Vendime e asamblese merren me votat e ortakeve qe perfagesojne me shume se gjysmen e pjeses se kapitalit themeltar.

Ne rast se kjo shume nuk sigurohet ne mbledhjen e pare, atehere thirret mbledhja e dyte, ne te cilen vendimet merren me shumice te thjeshte votash, pavaresisht nga pjesa e kapitalit qe ata perfagesojne.

Vendimet e Asamblese qe shqyrtojne ndryshime te statutit, kerkojne shumicen pro te 3/4 te pjeseve te kapitalit themeltar.



6 





K R E U IV

**ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

N E N I 13

Shoqeria administrohet nga dy administratore mandati i te cileve percaktohet me vendim te Asamblese se ortakeve dhe gjate dy vjeteve eshte i rinovueshem nga Asamblea e ortakeve. Nepermjet Asamblese se ortakeve shoqeria mund te rinovoje apo te revokoje mandatin e administratorit.

Kundershtimi i veprimeve te nje administratori nag administratori tjetër nuk sjell pasoja per te tretet.

N E N I 14

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Atij i takon firma dhe perfaqesimi i shoqerise, sipas kompetencave te dhena nga Asamblea e ortakeve.

N E N I 15

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te rasteve kur ajo provon se te tretet ishin ne dijeni qe administratori kishte tejkeluar objektin e veprimtarise se shoqerise, ose kur ne rrethana te caktuara nuk mund ta injoronin kete fakt.



## N E N I 16

Administratori i ndalohet te kontraktoje me shoqerine ne cdo forme. Ai pergjigjet perpara shoqerise per veprimet e kryera ne kundershtim me ligjin, statutin apo per faje te kryera gjate ushtrimit te detyres.

Pasojt e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve qe i sjellin dem shoqerise, jane ne ngarkim te administratorit.

## K R E U V

### KONTROLLI I ORTAKEVE

## N E N I 17


Cdo ortak jo administrator ka te drejten qe dy here ne vit t'i paraqese administratorit kerkese me shkrim per te kerkuar sqarime lidhur me marreveshjen e puneve te shoqerise.

Ortaket qe zoterojne te pakten 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar mund te kerkojne gjyqesisht caktimin e eksperteve kontabel per verifikimin e nje operacioni apo te veprimtarise se shoqerise ne pergjithesi.

Mandati i ekspertit eshte 6(gjashte) mujor.

## N E N I 18

Shoqerite qe ne mbyllje te vitit financiar tejkalojne dy



prej tre shifrave te meposhtme jane te detyruar te caktojne nje ekspert.

- Bilanci ne mbyllje te vitit eshte 12(dymbedhjete) milion leke
- Vlera e te ardhurave nga qarkullimi, pasi eshte zbritur tatimi mbi qarkullimin ne mbyllje te vitit eshte 24 (njezet e kater) milione leke.
- Shoqeria ka mesatarisht 50 (pesedhjete) te punesuar gjate vitit

#### N E N I 19

Viti financiar i shoqerise mbyllet ne 31.12. te cdo viti. Ne kete rast administratori ben inventarin dhe llogarite vjetore sipas dispozitave per kontabilitetin dhe harton nje raport me shkrim per administrimin brenda 31 diteve nga 31.12, qe d.m.th. brenda 31 Janarit te vitit ne vazhdim te vitit te cilit i referohet bilanci.

Bilancit i bashkohen:

- Nje situacion per garancite e dhena nga shoqeria.
- Nje situacion per sigurimet e bera nga shoqeria.

Keto dokumente vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te pakten nje muaj perpara mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.

Bilanci duhet te paraqitet brenda 31.03. te vitit pasardhes.

#### N E N I 20

Perderisa "rezerva e domosdoshme" te arrije 1/10 e vleres se

9

kapitalit themeltar, shoqeria eshte e detyruar te depozitoje ne fund te cdo viti 1/20 e fitimit te realizuar.

Fitimet ndahen mes ortakeve ne perputhje me raportet e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ortaket qe i konsiderojne dividendet jo ne perputhje me fitimet e realizuara kane te drejten qe brenda tre vjeteve t'ua reklamojne kete te tjere.

#### N E N I 21

Me vendim te Asamblese se ortakeve apo te Gjykates, shoqeria mund te deklarohet si shoqeri ne likuidim. Likuidatori, i cili mund te caktohey nga Asamblea e Ortakeve ashtu dhe nga gjykata, me nje mandat jo me te gjate se 3 (tre) vjet.

Gjate mandatit te tij , likuidatori ka te gjitha kompetencat e Administratorit.

#### N E N I 22

Likuidatori eshte pergjegjes perpara shoqerise per veprimet e tij.

Ortaket ruajne te drejten e kontrollit te veprimtarise se likuidatorit.

